



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 3143 prot.,

Tiranë, më 5.11.2020

VENDIM

NR. 106, DATË 05.11.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E AMA-S, NR. 131, DATË 30.09.2019 "PËR PAJISJEN E SHOQËRISË "ORA" SH.A., ME LICENCË PËR SHËRBIMIN E PROGRAMIT AUDIOVIZIV "TV ORA NEWS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 138, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

- Në vendimin e AMA-s, nr. 131, datë 30.09.2019 "Për pajisjen e shoqërisë "Ora" sh.a., me licencë për shërbimin e programit audioviziv "TV Ora News", të ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
  - Emërtimi "Tv Ora News", zëvendësohet në çdo vend me "Tv Ora".
  - Pika 1 e vendimit, ndryshon si vijon:

*"Pajisjen e shoqërisë "Ora" sh.a., me licencë shërbimi programi audioviziv "Tv Ora", për të ofruar shërbim në qarqet Fier, Tiranë, Durrës dhe Vlorë".*
  - Pika 3, ndryshon si vijon:

*"Masa e pagesës vjetore për licencë shërbimi programi audioviziv mbështetur në rrjet numerik tokësor në qarqet Fier, Tiranë, Durrës dhe Vlorë do të jetë sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e pagesave në fuqi".*
- Licenca e shoqërisë "Ora" sh.a., për transmetime analoge bëhet e pavlefshme.
- Ngarkohet administrata e AMA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 01.10.2020.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtar:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA